

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji për “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim i BE-së
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Rregullorja (KE) nr. 765/2008 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008, “Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe shfuqizimin e Rregullores (KEE) nr. 339/93”, Numri CELEX: 32008R0765, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. L 218, datë 13.8.2008, faqe 30-47, amenduar ne 2021 https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02008R0765-20210716
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Programi qeverisës 2021-2025 ¹ , SKZHIE 2022-2030 ² , PKIE 2023-2025 ³
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	22/05/2023
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	29/06/2023
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 23/05/2023
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2023 – MFE – Nr. 7
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Pravera Fagu Pranvera.fagu@dpa.gov.al Ardita Mele Ardita.fuga@dpa.gov.al 0693674925
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	

¹ https://kryeministria.al/ep-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf

² <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/03/01/122>

³ <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88>

Problemi në shqyrtim lidhet me nevojën për harmonizimin e plotë të legjislacionit në fushën e akreditimit me Rregulloren e (BE) 765/2008 “Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe shfuqizimi i Rregullores 339/93” dhe me praktikat europiane në fushën e akreditimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri funksionon në bazë të Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, i cili është miratuar në vitin 2014, dhe në nenin 5 janë listuar organet e vlerësimit të konformitetit të cilat njiheshin në atë kohë, të cilave ju ofrohej shërbimi i akreditimit. Por, që nga ajo kohë akreditimi është zhvilluar shumë dhe legjislacione apo praktika të ndryshme europiane kanë përfshirë shërbimin e akreditimit edhe në organe të tjera të vlerësimit të konformitetit. Në këto kushte, lind domosdoshmëria e ndryshimit dhe përafrimit të legjislacionit në fushën e akreditimit me atë evropian, për adresimin e disa mangësive në ligjin ekzistues.

OBJEKTIVAT

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen nëpërmjet miratimit të kësaj politike janë:

- 1) Përfshirja e vlerësimeve të reja të konformitetit në fushën e veprimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA), brenda vitit 2023;
- 2) Sigurimi i zbatimit në masën 100% i standardit ISO/IEC 17011:2017 “Kërkesa për organizmat akreditues që akreditojnë organe të vlerësimit të konformitetit” në lidhje me kontrollet e brendshme brenda vitit 2023.
- 3) Harmonizimi 100% i legjislacionit aktual me legjislacionin e BE-se, perkatesisht Rregullorja (KE) nr. 765/2008 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008, “Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe shfuqizimin e Rregullores (KEE) nr. 339/93”, brenda vitit 2023.
- 4) Harmonizimi 100% i ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” me Kodin e Procedurave Administrative, për rastet e ankimimeve administrative.
- 5) Kryerja e promovimit të akreditimit me qëllim rritjen e numrit të organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituar dhe si rrjedhim edhe rritjen e mbrojtjes së konsumatorit dhe reduktimin e barrierave teknike në tregti, brenda vitit 2023
- 6) Zbatimi në masën 100% i standardit ISO/IEC 17011:2017 “Kërkesa për organizmat akreditues që akreditojnë organe të vlerësimit të konformitetit” në lidhje me rritjen e kapaciteteve vlerësuese të trajnuara brenda vitit 2023.

OPSIONET E POLITIKAVE

Opsioni 0 (status quo): vijimi me ligjin aktual, nuk përmbushet detyrimi për përafrimin me legjislacionin e BE dhe praktikat europiane në fushën e akreditimit, si dhe nuk zbatohen legjislacionet e fushave të tjera ku kërkohet akreditimi.

Opsioni 1 (jo rregullator): Vetërregullimi ose ndërgjegjësimi i organeve të vlerësimit të konformitetit nuk adreson siç duhet problemin me masat e duhura.

Opsioni 2 (rregullator): Ndryshimi i ligjit ekzistues është masë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për adresimin e problemit.

Opsioni 3 (rregullator): Hartimi i një ligji të ri është masë e tepruar dhe jo proporcionale me ndryshimet ligjore të nevojshme për tu bërë.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Lidhur me ndikimin financiar ndryshimi i ligjit egzistues nuk do të ketë efekte në buxhetin e shtetit pasi vlerësimet e reja që do të përfshihen në nismën ligjore nuk kërkojnë ngirtjen e strukturave të reja. Ato do të kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Hartimi i procedurave të reja për kryerjen e vlerësimeve të reja do të bëhet nga DPA bazuar në standardet dhe aktet e BE. Ndryshimi i ligjit egzistues nuk ka asnjë ndikim në mjedis.

Ndikim social – Ndikimi social parashtrohet si vijon:

- Harmonizimi i plotë të legjislacionit në fushën e akreditimit me legjislacionin evropian, duke kontribuar në anëtarësimin e Shqipërisë në BE.
- Plotësimi 100% i kërkesave të standardit si garanci për plotësimin e kërkesave për nënshkrimin e marrëveshjeve të njohjes reciproke me organizmat ndërkombëtare dhe si rrjedhim edhe njohje e raporteve të testimit, certifikatave të certifikimit dhe inspektimit në botë.
- Ndikim pozitiv në ofrimin e shërbimit të akreditimit e cila sjell rritjen e besueshmërisë së konsumatorëve dhe tregu do të ketë produkte të sigurta.
- Konkurrencë të ndershme i në treg ndërmjet organe të akredituara përmes ofrimit të shërbimit të akreditimit tek organet e vlerësimit të konformitetit, etj.
- Siguri tek konsumatorët për produktet të cilat do të certifikohen sipas standardeve ndërkombëtare.
- Zhvillimi i studimeve të ndryshme, politikave etj përmes shërbimeve të akreditimit.
- Marrja e trajnimeve të përshtatshme, njohja me risitë dhe ndryshimet e standardeve duke përmirësuar aftësisë vlerësuese për vlerësues teknik.

Për DPA-në: Përmirësimi i procedurës së akreditimit dhe funksionimit të institucionit, si dhe zgjerimin e fushës së veprimit. Gjithashtu, përmirësimi do të sigurojë që cdo zhvillim të mundshëm të fushave apo veprimtarive ku kërkohet akreditimi, DPA të ketë mundësi ta ofrojë si shërbim pa nevojën e ndryshimeve ligjore. Përfshirja e vlerësimeve të reja të konformitetit në fushën e veprimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA), rregullimi i procedurës së kontrollit të brendshëm i cili është i detyrueshëm për DPA-në në përputhje me standardin ISO/IEC 17011:2017, shmangia e konfliktit të interesave në veprimtarinë e DPA dhe në mënyrën e organizimit të saj, ndryshimi i afateve ligjore në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative për rastet e ankimimit administrative, si dhe përmirësimi i legjislacionit aktual për akreditimin.

Për OVK-të: Ofrimi i shërbimit tek organet e vlerësimit të konformitetit do të sjell jo vetëm zbatim të legjislacionit vendas por edhe kryerje të veprimtarisë së vlerësimit të konformitetit. Ofrimi i shërbimit të akreditimit ka vetëm ndikim pozitiv pasi besueshmëria e konsumatorëve do të rritet dhe tregu do të ketë produkte të sigurta. Nga ana tjetër, kryerja e veprimtarisë së vlerësimit të konformitetit do të ndihmojë zhvillimin dhe daljen e produkteve të reja si dhe inovacionin.

Për konsumatorët- të cilët janë gjithmonë të interesuar për produkte dhe shërbime të sigurta, do të sjellë edhe rritje të besueshmërisë e tyre në sigurinë e produkteve të cilat do të certifikohen sipas standardeve ndërkombëtare dhe ulje të cmimeve të produkteve.

Për rregullatorët: ndryshimi ligjor do të arrijë objektivat e vendosura për përmirësimin e mirëqënies së popullatës, do të rrisë eksportet, do të ulë burokracitë dhe do të hedh një hap përpara drejt anëtarësimin në BE.

Për biznesin dhe industrinë- Përmes akreditimit të vlerësimeve të reja, bizneseve iu garantohej lëvizja e lirë e mallrave pa pasur nevojën e ri-testimit, apo ri-kalibrimit në aktivitetet e eksport/importit. Bazuar në parimin „një testim, një certifikim, një akreditim“ mundësohet lëvizje e lirë e produkteve dhe shërbimeve me minimumin e kostove. Përmes akreditimit do të kufizohen e gabimet në prodhimin e produkteve; uljet e gjobave dhe shmangia e rritjes së kostos së testeve dhe certifikimeve.

Për organizatat dhe shoqatat e shoqërisë civile do të ndikojë në marrjen e shërbimeve të akredituara me qëllim arritjen e objektivave dhe politikave të tyre. Marrja e shërbimeve të akredituara ndikon në rezultate të besueshme dhe si rrjedhim shumë studime, politika, etj do të mund të zhvillohen.

Për ekspertë e fushës- Kjo politikë do të ndikojë edhe ky grup në përfshirjen e tyre në dhënien e shërbimit të akreditimit. Marrja e trajnimeve të përshtatshme, njohja me risitë dhe ndryshimet e standardeve do të sjellë përmirësimin e aftësisë së tyre vlerësuese për shkak të plotësimit të kërkesave për të qënë vlerësues teknik.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Opsioni i zgjedhur është Opsioni 2 - Miratimi i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë””, i cili sjell rregullimin ligjor lidhur me:

Së pari: ndryshimi i ligjit aktual është mënyra më efektive për të garantuar përafrimin në mënyrë të plotë të legjislacionit shqiptar me atë të BE në fushën e akreditimit dhe praktikave europiane. Ky opsion realizon ofrimin e shërbimit të akreditimit tek organet e vlerësimit të konformitetit, duke plotësuar kështu zbatimin e legjislacioneve në fusha të ndryshme ku kërkohet vlerësimi i konformitetit i akredituar.

Ndryshimi i ligjit është mjet i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm, pasi problematikat e evidentuara mund të adresohen më së miri me ndryshimin e dispozitave në fuqi. Problemi ka karakter legjislativ dhe çdo opsion me karakter jorregullator nuk i shërben qëllimit dhe arritjes së objektivave.

Së dyti: miratimi i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”” sjell rregullimin ligjor lidhur me përafrimin i nenit 8 pika 1 i Rregullores Evropiane 765/2008 në legjislacionin aktual në fushën e akreditimit, konkretisht me mënjanimin e konfliktit të interesave dhe ekzistencën e organizmit akreditues si organizëm i pavaruar nga organet e vlerësimit të konformitetit që ky organizëm akrediton.

Së treti: Ky projektligj do të sjellë përfshirjen e vlerësimeve të reja të konformitetit në fushën e veprimtarisë së DPA, si biobankat. Gjithashtu do të rregullojë procedurën për kryerjen e kontrolleve të brendshme përmes përdorimit të audituesve të huaj apo vendas të cilët kanë kompetencë në fushën e akreditimit, që janë të pavarur dhe të paanëshëm, që njohin kërkesat e Rregullores Evropiane 765/2008, standardit ISO/IEC 17011:2017 dhe dokumentat e Organiztës Evropiane për Akreditim (EA), ILAC dhe IAF është një domosdoshmëri.

Së katërti: Saktësime ligjore të dispozitave aktuale në lidhje me afatet e ankimimit në përputhje me sa parashtruar në Kodin e Procedurave Administrative.

Theksojmë se edhe nga analiza me shumë kritere që është kryer ka rezultuar se opsioni 2 është më i preferuar duke grumbulluar 91 pikë ndërkohë që opsioni 3 ka 71 pikë.

Ky projektligj nuk sjell kosto në buxhetin e shtetit.

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-veçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë – *Te plotesohet nese eshte e mundur*):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet

KONSULTIMI

Procesi i konsultimit filloi me publikimin në RENJK të njoftimit paraprak sipas legjislacionit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik në periudhën 22.5.2023 - 22.6.2023. Me anë të këtij njoftimi, DPA ka kërkuar informacion ose opinion paraprak për çdo çështje apo problematikë me të cilën subjektet kanë hasur gjatë zbatimit të ligjit nr 116/2014. Gjithashtu, janë kërkuar informacione/opinion që i shërbejnë përmirësimit të ligjit për akreditimin. Në përfundim të afatit të parashikuar nga ligji nr. 146/2014, projektligji është lexuar nga 289 persona dhe nuk janë dërguar komente përmes RENJK.

Gjithashtu, edhe në rrugë shkresore nuk ka patur komente apo sugjerime nga grupet e interesit në lidhje me projektligjin.

Projektligji është ripunuar bazuar në mendimet e ardhura nga ministrinë e linjës.

Ministria e Shëndetësisë është shprehur dakord me projektligjin e propozuar.

Ministria e Drejtësisë është shprehur dakord duke sugjeruar çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legjislative dhe terminologjisë juridike dhe konkretisht:

“ - *Komenti 2.1 për përdorimin e teknikës legjislative është marrë parasysh;*

Komenti 2.2 për dhënien e përkufizimit të termit “Biobankë” është reflektuar në nenin 1 të projektligjit. Për sa i takon përcaktimit konkret të organeve të vlerësimit të konformitetit, nuk mund të përcaktohen pasi kjo është në varësi të legjislacionit evropian i cili është në zhvillim të vazhdueshëm. Ky formulim do të përdoret në projektligj në mënyrë që për çdo zhvillim të legjislacionit evropian të mos jetë e nevojshme ndryshimi i Ligjit nr. 116/2014;

Komenti 2.3 në lidhje me formulimin e nenit 2 të projektligjit, është marrë parasysh;

Komenti 2.4 për autoritetin e DPA për promovimin e akreditimit, DPA ka përfshirë në nenin 3 të projektligjit edhe ndryshimin e nenit 6 shkronja (dh) të Ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë duke përfshirë si përgjegjësi të DPA edhe promovimin e akreditimit. Për sa i takon përdorimit të auditorëve, DPA ka përfshirë në nenin 4 të projektligjit edhe rishikimin e pikës 7 të nenit 9 të Ligjit nr. 116/2014 ku është përfshirë kryerja e kontrolleve të brendshme siç kërkohet nga paragrafi 9.7 i standardit ISO/IEC 17011:2017 “kërkesa për organizmat akreditues që akreditojnë organe të vlerësimit të konformitetit. Kryerja e kontrolleve të brendshme është një kërkesë edhe nenit 9 pika 7 e Ligjit nr. 116/2014. Për kryerjen e kontrolleve të brendshme DPA do të përdorë auditues vendas apo të huaj të cilët njohin kërkesat e standardit ISO/IEC 17011:2017, kërkesat e Rregullores Evropiane (KE) 765/2008 dhe kërkesat e dokumenteve të lëshuara nga EA, ILAC dhe IAF. Në lidhje me trajnimin dhe zhvillimin e aftësive/kompetencës të

vlerësuesve teknik në Ligjin nr. 116/2014, neni 9, pika 8 dhe 9, kërkojnë që procesi i akreditimit duhet të kryhet nga persona kompetent, prandaj trajnimi dhe zhvillimi i tyre është domosdoshmëri. Në standardin ISO/IEC 17011:2017, paragrafi 6, kërkon që organizmi akreditues duhet të sigurojë kompetencën e personelit që ajo përdor.”

Ministria e Drejtësisë me shkresën e datës 09.06.2023 në sistemin e-akte ka parashtruar komentet të tjera, si më poshtë vijon:

“1. Mbi ligjshmërinë e formës dhe përmbajtjes 1.1. Ministri i Drejtësisë shprehet dakord me miratimin e tyre nga Këshilli i Ministrave në formën dhe përmbajtjen e propozuar, duke sugjeruar çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legjislative dhe terminologjinë juridike të projektakteve si vijon: 2. Mbi çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legjislative 2.1. Në përputhje me nenin 37 të udhëzimit nr.6, datë 29.04.2022, “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”, formulat ndryshuese të parashikuara në nenet 1, 2, 4 të projektligjit të riformulohen si vijon: “Në nenin 3, pas pikës 16 shtohet pika 17 me këtë përmbajtje:”;... “Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë”;... “Në nenin 9 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë: ..Pika 1 ndryshohet si më poshtë...Pika 7 ndryshohet si më poshtë...” 2.2. Në funksion të qartësisë në nenin 1 të projektligjit termi “organ” të zëvendësohet me togfjalëshin “një person juridik publik”. Gjithashtu, në nenin 3 të projektligjit të përcaktohet konkretisht së për cilat subjekte do të kryhen trajnimet në fushën e promovimit të akreditimit. 2.3. Në nenin 4 të projektligjit të hiqen nga përmbajtja e tij parashikimet për shpenzimet e akomodimit si fjetje, ushqim dhe transport, në kushtet kur janë të parashikuara në pikat 11 dhe 18 të vendimit nr.737, datë 09.09.2015 të Këshillit të Ministrave.”

Në lidhje me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë janë bërë ndryshimet përkatëse :

- Komentet e pikës 2.1 të bëra nga Ministria e Drejtësisë janë marrë të gjitha parasysht
- Komenti 2.2 në lidhje me termin "organ" nuk është ndryshuar pasi pasi i referohet Organeve të Vlerësimit të Konformitetit, term i cili aktualisht përdoret në ligjin 116/2014.
- Komenti në pika 2.2 në lidhje me promovimin e akreditimit, reflektuar në nenin 3 për të mos krijuar keqkuptime.
- Komenti 2.3 është marrë parasysht dhe është reflektuar në nenin 4 të projektligjit.

Ministria e Drejtësisë është shprehur dakord me komentet e reflektuara në projektligj.

Ministria e Mjedisit dhe Turizmit është shprehur për riformulimin e nenit 1 të projektligjit. Ky koment është marrë parasysht. Meqenëse akreditimi i organeve që kryejnë verifikim dhe vlefshmërinë bazohet në standardin ISO 17029:2019 dhe ky standard përdoret nga organet që kryejnë verifikim dhe vlefshmërinë si veprimtari të vlerësimit të konformitetit në çdo sektor është propozuar riformulimi i këtij neni. Në përmbushje të komenteve të dhëna nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit është riformuluar neni 1 dhe nga ana e këtij institucioni është shprehur dakordësia mbi reflektimin e ndryshimeve të kërkuara nga e tyre, konfirmimi i dhënë në sistemin e-akte me shkresën datë 06.06.2023.

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori ka shprehur komente në lidhje me përfshirjen në relacion të faktit që kjo iniciativë ligjore është parashikuar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 – 2025 dhe rishikimin e tabelave të përputhshmërisë. Këto komente janë marrë parasysht.

Në datën 07.05.2023 u zhvillua një takim në ambjentet e DPA-së me bordin e akreditimit, ku përfshihen të gjitha palët e interesuara për akreditimin (organet e vlerësimit të konformitetit, biznesi, institucionet shkencore dhe shoqatat e konsumatorëve) dhe u diskutua për ndryshimet në ligjin nr. 116/2014. Pjesëmarrësit bënë pyetje, komente dhe sugjerime në lidhje me draft ligjin, të cilat nga ana jonë u morën në konsideratë gjatë hartimit të versionit përfundimtar të projektligjit.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Nisma ligjore e paraqitur do të zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e cila ofron shërbimin e akreditimit tek organet e vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë.

Monitorimi do të kryhet nga ministria përgjegjëse për çështjet e tregtisë, si institucion përgjegjës për mbikqyrjen e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, në bazë të kompetencave të dhëna nga Ligji nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Tregues i suksesit të projektligjit do të jetë rritja e numrit të organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituara, si dhe zbatimi i standardeve dhe praktikave europiane në fushën e akreditimit.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës

Akreditimi në Shqipëri ka filluar në vitin 1993 dhe në atë kohë ky shërbim ofrohej nga sektori i Akreditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardeve dhe Cilësisë. Gjatë negociatave për anëtarësim në Organiztën Botërore të Tregtisë (OBT) u rekomanduar ndarja e akreditimit nga standardizimi. Në vitin 2003 me miratimin e Ligjit nr. 9024 datë 06.03.2003 “Për akreditimin e laboratorëve testues, kalibruës, organizmave certifikues dhe inspektues në Republikën e Shqipërisë” u krijua Drejtoria e Akreditimit në varësi të ministrisë që mbulonte çështjet e tregtisë. Në vitin 2007 u miratua Ligji nr. 9824 datë 11.11.2007 “Për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” dhe u shfuqizuar Ligj nr. 9024 datë 6.03.2003.

Me miratimin e Rregullores Evropiane 765/2008⁴ doli e nevojshme ndryshimi i legjisllacionit në fushën e akreditimit në përputhje me Rregulloren Evropiane. Për këtë arsye në vitin 2014 u miratua Ligji nr. 116/2014 ‘Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë’. Ligji nr. 116/2014 ka shfuqizuar Ligjin nr. 9824, datë 1.11.2007. Në përputhje me Ligjin 116/2014 u miratuan aktet nënligjore përkatëse Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 667 datë 29.07.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”, VKM nr. 737 datë 09.09.2015 “Për përcaktimin e tarifave të akreditimit dhe për trajnimet e organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, i ndryshuar me VKM nr. 53 datë 27.01.2016. Kjo bazë ligjore ka harmonizuar 98% të Rregullores Evropiane 765/2008.

⁴ <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:218:0030:0047:en:PDF>

Bazuar në këtë kuadër ligjor është krijuar dhe funksionon Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) si i vetmi organizëm kombëtar i akreditimit në vend i cili është institucion buxhetor në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e tregtisë. Gjithashtu, në këtë akt është parashikuar baza ligjore dhe parimet ku bazohet akreditimi, parimet e përgjithshme, kriteret për organizmin kombëtar të akreditimit, përgjegjësitë e DPA, vlerësimi i ndërsjellë, përputhshmëria me kërkesat për njohjen reciproke, etj.

Bazuar në Ligjin nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, DPA funksionon si i vetmi organizëm kombëtar i akreditimit, i paanshëm dhe i pavarur. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: a) laboratorë testues, mjekësorë dhe kalibruer; b) organe certifikuese të sistemeve të menaxhimit; c) organe certifikuese të personelit; ç) organe certifikuese të produkteve; d) organe inspektuese; dh) organe që realizojnë teste zotësie dhe krahasime ndërlaboratorike; e) organe që prodhojnë materiale referuese të certifikuara.

DPA ka ofruar shërbimin e akreditimit me profesionalizëm dhe kompetencë për këto fusha. DPA është anëtare nënshkruese e marrëveshjeve të njohjes reciproke me EA në fushën e testimit, inspektimit, certifikimit të sistemeve të menaxhimit dhe certifikimit të personave. DPA është nënshkruese e marrëveshjeve të njohjes reciproke edhe me organizmat botërore të akreditimit, Bashkëpunimi ndërkombëtar për akreditimin e laboratorëve (ILAC) dhe Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit (IAF).”

Në raport-progresin e BE për Shqipërinë të vitit 2022, është raportuar se legjislacioni në fushën e akreditimit të organeve të vlerësimit të konformitetit nuk është në përputhje të plotë me Rregulloren (EC) Nr. 765/2008 “Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe shfuqizimin e Rregullores (EEC) Nr. 339/93”. Në ligjin aktual nr. 116/204 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, nuk është përafuar neni 8 pika 1 e Rregullores Evropiane 765/2008 që ka lidhje me mënjanimin e konfliktit të interesave dhe ekzistencën e organizmit akreditues si organizëm i pavaruar nga organet e vlerësimit të konformitetit që ky organizëm akrediton.

Problemi në shqyrtim

1. *Përshkruani natyrën e problemit.*
2. *Identifikoni shkaqet e problemit.*
3. *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
4. *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
5. *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Natyra e problemit ka karakter legjislativ. Në raport-progresin e BE për Shqipërinë të vitit 2022, është raportuar se legjislacioni në fushën e akreditimit të organeve të vlerësimit të konformitetit nuk është në përputhje të plotë me Rregulloren (EC) Nr. 765/2008 “Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe shfuqizimin e Rregullores (EEC) Nr. 339/93”. Pas analizës së thelluar që u bë u konstatua si problematikë mospërafrimi i nenit 8 pika 1 i Rregullores Evropiane 765/2008 në legjislacionin aktual në fushën e akreditimit. Mungesa e parashikimit të nenit 8 pika 1 e Rregullores Evropiane ka sjellë jo vetëm mosharmonizimin 100% të legjislacionit në fushën e akreditimit me Rregulloren Evropiane por edhe është vënë në pikëpyetje pavarësia dhe mënjanimi i konfliktit të interesave për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit.

Në ligjin nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlersimit të konformitetit”, neni 5 janë përcaktuar organet e vlerësimit të konformitetit të cilave organizmi akreditues ju ofron shërbimin e akreditimit. Shumë legjislacione evropiane të miratuara pas vitit 2014, kohë në të cilën është miratuar ligji për akreditimin dhe

shumë praktika evropiane të dhëna në dokumentin EA 1/06 A AB⁵, kërkojnë përfshirjen e vlerësimit të konformitetit të akredituar. Një pjesë e këtij kuadri ligjor evropian është transpozuar tashmë edhe në legjislacionin shqiptar si psh. Ligji nr. 2/2023⁶ “Për gazet serrë të fluorinuara” që përafrohet në mënyrë të pjesëshme Rregulloren e Këshillit dhe Parlamentit Evropian (EC) nr.EC/517/2014, e datës 16 prill 2014 “Mbi gazet serrë të fluorinuara” që shfuqizon rregulloren (EC) nr.842/2006.

Sa më sipër, problem kryesor në vetvete është mungesa e fushave të akreditimit dhe shkak është pikerisht mungesa e parashikimit në ligjin aktual i të gjitha fushave të mundshme të akreditimit.

Për ta ilustruar në mënyrë më të detajuar këtë problematikë, kemi një shembull konkret ku për zbatimin e kuadrit ligjor shqiptar, shumë organe të vlerësimit të konformitetit (si organet që kryejnë vlefshmërinë dhe verifikimin apo biobankat) kanë kërkuar akreditim në DPA, por për shkak se këto vlerësime mungojnë në fushën e veprimtarisë së DPA, shërbimi i akreditimit nuk i është ofruar. Kjo ka çuar në mos zbatimin e legjislacioneve në fusha të caktuara. Prandaj doli e nevojshme përfshirja e vlerësimeve të reja në fushën e veprimtarisë së DPA.

DPA kryen kontrolle të brendshme për plotësimin e kërkesës së paragrafit 9.7 të standardit ISO/IEC 17011:2017 dhe për sigurimin e përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimit të akreditimit. Në ligjin aktual thuhet që DPA duhet të ketë procedurë për kryerjen e kontrolleve të brendshme, por nuk thuhet se kush e kryen atë. Përdorimi i audituesve të huaj apo vendas të cilët kanë kompetencë në fushën e akreditimit, që janë të pavarur dhe të paanëshëm, që njohin kërkesat e Rregullores Evropiane 765/2008, standardit ISO/IEC 17011:2017 dhe dokumentat e Organiztës Evropiane për Akreditim (EA), ILAC dhe IAF është një domosdoshmëri. Përdorimi i audituesve të huaj apo vendas kërkon edhe rregullimin e marrëdhënieve financiare të tyre me DPA. Pra në këtë kontekst, ligji aktual nuk përcakton saktë strukturën përgjegjëse për auditimin dhe kryerjen e kontrolleve të brendshme, si dhe në rastin e kontraktimit të audituesve të huaj apo vendas (të pavarur) nuk rregullon në mënyrë shteruese mënyrën e financimit të tyre.

Në ligjin aktual afati për vendimet administrative të marra nga DPA është parashikuar në kundërshtim me afatet aktuale të parashtruara në Kodin e Procedurave Administrative. Ligji nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” është miratuar në vitin 2014, ndërkohë që KPA është miratuar në 30.4.2015 dhe ka hyrë në fuqi 1 vit pas botimit në Fletoren Zyrtare. Për këtë arsye del e nevojshme që ky afat të jetë në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative për rastet e ankimimit administrative.

Përfshirja e vlerësimeve të reja të konformitetit në fushën e veprimtarisë së DPA sollti si domosdoshmëri edhe përfshirjen e një përkufizimi për biobankat. Biobankat janë organe të cilat ruajnë mostra biologjike njerëzore dhe informacione shoqërore të organizuara në mënyrë sistematike për qëllime kërkimore. Akreditimi i biobankave bazohet në standardin EN ISO 20387:2018⁷ Bioteknologji - Biobank - Kërkesa të përgjithshme për biobank dhe si e tillë përkufizimi është marrë nga ky standard.

Grupet e prekura nga këto problematika janë:

- a) Grupet që preken në mënyrë të drejtëpërdrejtë:
 - Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit-e cila do të plotësojë detyrimin ligjor për harmonizimin e plotë të legjislacionit në fushën e akreditimit me legjislacionin evropian dhe mospërputhshmëria nuk do të evidentohet më si gjetje në progress raportet e BE. Gjithashtu ndryshimi i politikës do të ndikojë në plotësimin 100% të të gjitha kërkesave për organizmat akreditues të dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017 “Kërkesa për organizmat akreditues që akreditojnë organet e vlerësimit të

⁵ AB <https://european-accreditation.org/ep-content/uploads/2018/10/ea-1-06-A-AB.pdf>

⁶ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/27/96199dbd-cac9-4bff-8cca-fa3142867412;q=ligji%20per%20gazet%20serre>

⁷ <https://eëë.iso.org/standard/67888.html>

konformitetit”, duke përfshirë këtu edhe kryerjen e kontrolleve të brendshme dhe trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve vlerësuese të DPA.

- Organet e vlerësimit të konformitetit - të cilat pa një rishikim të fushave të akreditimit, me vullin e zhvillimit që po merr legjislacioni dhe ekonomia në të gjitha fushat e saj nuk do të kenë mundësinë të përfitojnë nga aktiviteti i akreditimit në RSH;
- b) Grupet që preken në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë:
 - Konsumatorët- të cilët janë gjithmonë të interesuar për produkte dhe shërbime të sigurta
 - Qeveria- për zbatimin e legjislacionit dhe arritjen e politikave dhe objektivave të saj për përmirësimin e mirëqënies së popullatës
 - Biznesi dhe industria- për sigurimin e vlerësimit të konformitetit të akredituar me qëllim ofrimin në treg të produkteve të sigurta në treg dhe rritjen e eksporteve.
 - Organizata dhe shoqatat e shoqërisë civile- marrjen e shërbimeve të akredituara me qëllim arritjen e objektivave dhe politikave të tyre.
 - Ekspertë të fushës- përfshirjen e tyre në dhënien e shërbimit të akreditimit
 - Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë- për ti ardhur në ndihmë biznesit me sigurimin e vlerësimit të konformitetit të akredituar.

Këto problematika mund të trajtohen përmes ndryshimit të politikës, duke ju dhënë mundësinë qytetarëve (konsumatorëve) për të përfituar produkte dhe shërbime të certifikuar dhe të testuara nga OVK-të e akredituara, sepse në këtë mënyrë përmbushen kërkesat në lidhje me cilësisë dhe sigurinë duke reduktuar rreziqet që lidhen me produktet dhe shërbimet.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Në programin e Qeverisë Shqiptare për vitet 2021 – 2025, një ekonomi e fortë bazuar në modernizim, produktivitet dhe konkurrueshmëri është cilësuar prioritet. Zhvillimi teknologjik do të nxisë prodhimin duke siguruar që kompanitë e suksesshme dhe ndërmarrjet e reja në vend të krijojnë një vlerë të shtuar në zinxhirin e prodhimit. Kjo do të çojë në rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Lehtësimi i tregtisë kërkon një fuqizim të mëtejshëm të institucioneve të specializuara që garantojnë lëvizjen e lirë të mallrave. Akreditimi është një nga instrumentet i cili redukton barrierat teknike në tregti dhe kjo arrihet nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të njohjes reciproke të organizmave akreditues me EA.”

Kjo nismë është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 – 2030, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 88, datë 22.2.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 – 2030”. Kjo Strategji në pikën “Mbrotjtja e konsumatorit dhe mbikëqyrja e tregut”, përcakton se “Infrastruktura e Cilësisë (standardizim, metrologji, akreditim, testim-certifikim, vlerësim konformiteti) përbën themelin e reformave në tregun brendshëm, të cilat krijojnë premisat për vendime të rëndësishme lidhur me cilësinë e jetës së qytetarëve, në lidhje me mbrojtjen e shëndetit, ambientit, sigurinë e përgjithshme teknike, mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorit dhe të sektorit privat, në lidhje me cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të prodhuara në Shqipëri”.

Gjithashtu kjo nismë ligjore synon përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian në përputhje masën prioritare të pikës “Qëllimi parësor: Integrimi evropian”, ku

përcaktohet se Shqipëria synon zbatimin e plotë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe sigurimin e përparimit në harmonizimin ligjor me *acquis* e BE-së. Me hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian, raportimi i përputhshmërisë së kuadrit ligjor në fushën e akreditimit me Rregulloren Evropiane 765/2008 është pjesë e Kapitulli 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”.

Kjo nismë është parashikuar në planin analitik të projektakteve për vitin 2023. Kjo nismë e propozuar është parashikuar si iniciativë në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 – 2025.

Me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë së akreditimit, lind domosdoshmëria e përmirësimit të kuadrit ligjor për të krijuar iniciativat e mëtejshme në rritjen e numrit të OVK-ve të akredituara, përmirësimin e dispozitave ekzistuese, si dhe adresimin e disa problematikave dhe mangësive në ligjin ekzistues.

Që prej fillimit të zbatimit të ligjit për akreditimin, DPA është angazhuar vazhdimisht në mënyrë që veprimtaria akreditimit në RSH të ofrohet sipas standardeve dhe rregulloreve evropiane. Gjatë veprimtarisë së këtij institucioni janë zhvilluar një sërë aktivitetesh me karakter informues për qytetarët në lidhje me aktivitetin e akreditimit. Në përmbushje të objektivave të saj DPA ka hedhur hapa përpara në rrugën e zgjerimit të marrëveshjeve të njohjes reciproke (MLA) duke u bërë nënshkruese e EA – MLA-së⁸. Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve ka sjellë një rritje të numrit të aplikimeve për t’u akredituar sepse certifikata lëshon DPA për fushat për të cilat është antare e EA-MLA-së njihen ndërkombëtarisht. Gjatë viteve të aktivitetit të saj DPA ka shtuar aktivitetin e akreditimit dhe vlerësimin e skemave të konformitetit.

Objektivi i politikës

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
 2. *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
 3. *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*
- a. Përfshirja e vlerësimeve të reja të konformitetit në fushën e veprimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA), brenda vitit 2023;
 - b. Sigurimi i zbatimit në masën 100% i standardit ISO/IEC 17011:2017 “Kërkesa për organizmat akreditues që akreditojnë organe të vlerësimit të konformitetit” në lidhje me kontrollet e brendshme brenda vitit 2023.
 - c. Harmonizimi 100% i legjislacionit aktual me legjislacionin e BE-se, perkatesisht Rregullorja (KE) nr. 765/2008 të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008, “Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe shfuqizimin e Rregullores (KEE) nr. 339/93”, brenda vitit 2023.
 - d. Harmonizimi 100% i ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” me Kodin e Procedurave Administrative, për rastet e ankimimeve administrative.
 - e. Kryerja e promovimit të akreditimit me qëllim rritjen e numrit të organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituar dhe si rrjedhim edhe rritjen e mbrojtjes së konsumatorit dhe reduktimin e barrierave teknike në tregti, brenda vitit 2023

⁸ MLA-marrëveshje ndërmjet organizmave kombëtar të akreditimit dhe organizmit Evropian të Akreditimit me qëllim njohjen e certifikatave të akreditimit

- f. Zbatimi në masën 100% i standardit ISO/IEC 17011:2017 “Kërkesa për organizmat akreditues që akreditojnë organe të vlerësimit të konformitetit” në lidhje me rritjen e kapaciteteve vlerësuese të trajnuara brenda vitit 2023

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

1. *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
2. *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
3. *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 (status quo): Status quo-ja ose mosndryshimi i gjendjes aktuale duke vijuar me kuadrin ligjor ekzistues, nuk përmbushet detyrimi për përafrimin me legjislacionin e BE dhe praktikën europiane në fushën e akreditimit, si dhe nuk zbatohen legjislacionet e fushave të tjera ku kërkohet akreditimi.

Opsioni 1 (jo rregullator): Vetërregullimi ose ndërgjegjësimi i organeve të vlerësimit të konformitetit nuk adreson siç duhet problemin me masat e duhura.

Opsioni 2 (rregullator): Ndryshimi i ligjit ekzistues është masë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për adresimin e problemit.

Opsioni 3 (rregullator): Hartimi i një ligji të ri është masë e tepruar dhe jo proporcionale me ndryshimet ligjore të nevojshme për tu bërë.

Opsioni 0 : Nuk ndërhyhet me ndryshim apo politikë të re dhe vijohet me kuadrin ligjor ekzistues e konkretisht me zbatimin e ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij opsioni nuk ndërmerret asnjë masë për të përafruar legjislacionin me atë të BE dhe praktikën europiane në fushën e akreditimit, si dhe nuk zbatohen legjislacionet e fushave të tjera ku kërkohet akreditimi. Ligji aktual ka nevojë të përmirësohet dhe duhet të përditësohet në fushën e akreditimit. Problematikat e këtij opsioni u trajtuan dhe në ceshtjen më sipër lidhur me problemin në shqyrtim, për këtë arsye vijimi me opsionin 0 është i pamundur.

Opsioni 1 (jo rregullator): Vetërregullimi ose ndërgjegjësimi i organeve të vlerësimit të konformitetit nuk adreson siç duhet problemin me masat e duhura. Sipas këtij opsioni jo vetëm nuk mund të arrihen rezultatet e dëshiruara, por dhe kostot do të rriten për shkak se, pavarësisht kryerjes së aktiviteteve ndërgjegjësuëse apo vetërregullimit, objektivat nuk mund të arrihen.

Opsioni 2 (rregullator): Ndryshimi i ligjit ekzistues është masë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për adresimin e problemit. Opsioni 2 ndikon në zbatimin e legjislacioneve në fusha të ndryshme të cilat kanë të parashikuar akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit dhe marrjen e shërbimeve nga organet e akredituara. Ky opsion siguron detyrimin e Shqipërisë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) për përmbushjen e detyrimit për përafrimin e legjislacionit të BE në fushën e akreditimit.

Opsioni 3 (rregullator): Hartimi i një ligji të ri për akreditimin për të adresuar problematikat dhe arritur objektivat. Sipas këtij opsioni hartohet dhe miratohet një ligj tërësisht i ri për akreditimin e organeve të

vlerësimin të konformitetit që shfuqizon ligjin aktual. Kjo është masë e tepruar dhe jo proporcionale me ndryshimet ligjore të nevojshme për tu bërë pasi:

- a) Kerkon nje kohe relativisht te gjate per tu finalizuar; kjo gjithashtu përkthehet edhe në kosto më të mëdha krahasuar me opsionet e tjera të konsideruara;
- b) Bazuar ne rregullat e teknikes legislative, duke qene se nderhyrjet e synuara prekin me pak se 50% te permbajtjes se ligjit aktual, ndermarrja e ketij opsioni do te ishte e panevojshme.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

1. *Identifikoni grupet e prekura.*
2. *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
3. *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 1. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 2. *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 3. *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 4. *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
4. *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 1. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 2. *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
5. *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 1. *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 2. *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
6. *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 1. *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 2. *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 3. *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Ndikim mjedisor – Nuk ka ndikim mjedisor.

Ndikim social – Ndikimi social jepet si më poshtë për grup të prekur.

Lidhur me ndikimet për secilin grup që preket nga ndryshimet e politikës së mësipërme parashikohet të sjellin ndikimet e mëposhtme:

Grupet e prekura nga këto problematika janë:

A Grupet që preken në mënyrë të drejtëpërdrejtë janë dy:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e cila do të plotësojë detyrimin ligjor për harmonizimin e plotë të legjislacionit në fushën e akreditimit me legjislacionin evropian dhe mospërputhshmëria nuk do të evidentohet më si gjetje ne progress raportet e BE.

Gjithashtu ndryshimi i politikës do të ndikojë në plotësimin 100% të të gjitha kërkesave për organizmat akreditues të dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017 “Kërkesa për organizmat akreditues që akreditojnë

organet e vlerësimit të konformitetit”, duke përfshirë këtu edhe kryerjen e kontrolleve të brendshme dhe trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve vlerësuese të DPA.

Plotësimi 100% i kërkesave të standardit është një garanci më shumë për plotësimin e kërkesave për nënshkrimin e marrëveshjeve të njohjes reciproke me organizmat ndërkombëtare dhe si rrjedhim edhe njohje e raporteve të testimit, certifikatave të certifikimit dhe inspektimit në botë. Kjo ndikon drejtëpërdrejtë në rritjen e eksporteve dhe si rrjedhim në rritjen e ekonomisë shqiptare.

Plotësimi 100% i kërkesave të standardit rrin edhe reputacionin dhe imaxhin e DPA krahas organizmave akreditues të vendeve të tjera të zhvilluara si edhe tek organet e vlerësimit të konformitetit.

Rritja e kapaciteteve vlerësuese të trajnuara na jep mundësinë e ofrimit të skemave të reja të akreditimit duke sjell rritje të numrit të organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituar. Rritja e numrit të OVK të akredituar sjell besueshmëri ttek konsumatorët dhe produkte më të sigurta në treg.

Rritja e numrit të OVK të akredituar sjell konkurrencë të ndershme dhe rritje të zbatimit të standardeve dhe legjislacionit. Njëpërmjet kësaj nisme ligjore do të realizohet promovimi i akreditimit, i rolit dhe rëndësisë së tij e cila do të sjell rritje të numrit të aplikimeve për akreditim.

Sa i takon ndikimit financiar në buxhetin e shtetit, vlerësojmë se ndryshimet e propozuara me ane të përzgjedhjes së opsionit të preferuar, aktualisht nuk shoqërohen me ndikime financiare shtesë në buxhetin e shtetit sepse kemi të bëjmë vetëm me ndryshime procedurale. Procedurat e akreditimit do të jenë të njëjta dhe nuk ka nevojë për ngritjen e strukturave të reja. Procedurat do të ndiqen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, e cila është strukturë ekzistuese dhe funksionale.

2. Organet e vlerësimit të konformitetit (OVK), që mund të jenë edhe ndërmarrje të vogla apo të mesme - të cilat me rishikimin e fushave të akreditimit, me vrullin e zhvillimit që po merr legjislacioni i BE dhe ekonomia në të gjitha fushat e saj do të kenë mundësinë të përfitojnë nga aktiviteti i akreditimit në RSH. Ofrimi i shërbimit tek organet e vlerësimit të konformitetit do të sjell jo vetëm zbatim të legjislacionit vendas por edhe kryerje të veprimtarisë së vlerësimit të konformitetit. Ofrimi i shërbimit të akreditimit ka vetëm ndikim pozitiv pasi besueshmëria e konsumatorëve do të rritet dhe tregu do të ketë produkte të sigurta.

Nga ana tjetër, kryerja e veprimtarisë së vlerësimit të konformitetit do të ndihmojë zhvillimin dhe daljen e produkteve të reja si dhe inovacionin. Kryerja e vlerësimeve të konformitetit të akredituara do të sjellë pasoja pozitive në eksportin e produkteve pasi produkteve shqiptare nuk do tju kërkohej riestimi dhe ricertifikimi në tregjet ku ato synojnë të vendosen. Kjo sjell jo vetëm zvogëlim të kostos por edhe vendosje të produktit në një kohë shumë të shkurtër në treg dhe si rezultat edhe nxitjen e zhvillimit të biznesit. Ofrimi i shërbimit të akreditimit tek organet e vlerësimit të konformitetit në disa fusha do të sjell një konkurrencë të ndershme pasi në treg do të ketë organe të akredituara.

Gjithashtu, sa i takon vlerësimit të ndikimit ekonomik, kjo politikë nuk do të detyrojë organet e vlerësimit të konformitetit të aplikojnë për akreditim tek organizmat akreditues të huaj duke sjell zvogëlim të kostos për akreditim dhe si rrjedhim edhe ulje të cmimeve të aktivitetit të vlerësimit të konformitetit që ato i ofrojnë klientëve të vet. Kjo padiskutim do të ketë ndikim të drejtëpërdrejtë në uljen e cmimeve të produkteve dhe shërbimeve dhe një konkurrencë të ndershme në treg. Megjithatë, kuantifikimi i ndikimit ekonomik në vlerë monetare është i pamundur të kryhet paraprakisht, sepse nuk mund të parashikohet se sa kërkesa për vlerësim konformiteti do të ketë në të ardhmen dhe në varësi të këtyre kërkesave sa do të jetë edhe ndikimi në çmimet e produkteve.

B Grupet që preken në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë

3. Konsumatorët- të cilët janë gjithmonë të interesuar për produkte dhe shërbime të sigurta, do të sjellë edhe besueshmërinë e tyre në sigurinë e produkteve të cilat do të çertifikohen sipas standardeve ndërkombëtare. Nga ana tjetër ulja e cmimeve të produkteve dhe shërbimeve do të ndikojë pozitivisht në ekonominë e tyre familjare, do të rrisë kënaqësinë kundrejt tregut të produkteve, si dhe do të rrisë mirëqenien për këtë grup të prekur.

4. Qeveria:

- do të arrijë objektivat e vendosura për përmirësimin e mirëqënies së popullatës;
- nëpërmjet ofrimit të vlerësimeve të reja të konformitetit të akredituara do të ketë një ndikim pozitiv në rritjen e eksporteve do të ulë burokracitë duke ndikuar drejtpërdrejtë edhe në rritjen e ekonomisë shqiptare;
- nëpërmjet harmonizimit të kuadrit ligjor me legjislacionin evropian vendi jone do të jetë një hap përpara anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

5. Biznesi dhe industria- Përmes akreditimit, bizneseve iu garantohet lëvizja e lirë e mallrave pa pasur nevojën e ri-testimit, apo ri-kalibrimit në aktivitetet e eksport/importit. Bazuar në parimin „ një testim, një certifikim, një akreditim “ mundësohet lëvizje e lirë e produkteve dhe shërbimeve me minimumin e kostove. Ritestimi dhe ricertifikimi që aktualisht kryhet pa ndërmarrjen e kësaj politike, në rastin më të mirë sjell vetëm rritje të kostos së produktit pasi si rezultat i pritjeve në kufi për kryerjen e testeve dhe certifikimeve produkti mund të prishej, gjë e cila shkakton humbje për biznesin dhe mund të çojë deri në falimentim të tij.

Përmes akreditimit e gjithë kjo situatë do të shmanget, sepse akreditimi ndihmon bizneset:

- në kufizimin e gabimeve në prodhim të produkteve;
- përmirësimin e cilësisë së prodhimit;
- rritjen e besueshmërisë tek klientet;
- shmangien e rritjes së kostos së produktit si pasojë e ritesteve dhe ricertifikimeve; një ndikim
- uljen e mundshme të gjobave për shkak të mosplotësimit të kërkesave të stadnardeve për prodhimin e produkteve.

6. Tek organizatat dhe shoqatat e shoqërisë civile do të ndikojë në marrjen e shërbimeve të akredituara me qëllim arritjen e objektivave dhe politikave të tyre. Marrja e shërbimeve të akredituara ndikon në rezultate të besueshme dhe si rrjedhim shumë studime, politika, etj do të mund të zhvillohen.

7.Ekspertë të fushës- Kjo politikë do të ndikojë edhe ky grup në përfshirjen e tyre në dhënien e shërbimit të akreditimit. Marrja e trajnimeve të përshtatshme, njohja me risitë dhe ndryshimet e standardeve do të sjellë përmirësimin e aftësisë së tyre vlerësuese për shkak të plotësimit të kërkesave për të qënë vlerësues teknik.

8.Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë- për t'i ardhur në ndihmë biznesit me sigurimin e vlerësimit të konformitetit të akredituar

Analiza e arsyetur më sipër është e bazuar në raport-progresin e BE për Shqipërinë të vitit 2022, Rregulloren (EC) Nr. 765/2008 “Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe shfuqizimin e Rregullores (EEC) Nr. 339/93”.

Serioziteti dhe shkalla e përhapjes së problemit është analizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, i cili është organi që në praktikë ka kompetencë për të ndjekur zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi për akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

1. *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
2. *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i zgjedhur është opsioni nr. 2 që parashikon ndryshimin e ligjit aktual nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”. Ky është parë si opsioni i preferuar, pasi nëpërmjet ndryshimit të dispozitave do të bëhej i mundur adresimi i problematikave me qëllim përafrimin e plotë me Rregulloren e (BE) 765/2008 e datës 9 Korrik 2008 “ Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe shfuqizimi i Rregullores (EEC) Nr. 339/93.

Përmes këtij opsioni arrihen objektivat dhe adresohen problemet që diktojnë nevojën për ndërhyrje dhe paraqet kosto më të ulët. Edhe nga pikëpamja e teknikës legjislative ky opsion është opsioni i preferuar për shkak se nuk parashikohet të kryhen ndryshime që prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit.

Ndryshimi i dispozitave aktuale është një mjet i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për adresimin e problemit dhe arritjen e objektivave, pasi problematikat e evidentuara mund të adresohen më së miri me ndryshimet në dispozitat e ligjit në fuqi. Duke qenë se ndërhyrja nuk lidhet me krijimin e një marrëdhënie të re juridike dhe as me rregullimin e një marrëdhënie për të cilën nuk ka tashmë një kuadër rregullator, ky opsion vlerësohet si opsioni i preferuar. Gjithashtu, ky opsion paraqet kohë më të ulët për përgatitjen dhe miratimin e nismës ligjore në mënyrë që adaptimi dhe përshtatja e ligjit aktual me Rregulloren 765/2008 të jetë i menjëhershëm.

Ruajtja e *status quo-s* ose ndërhyrja jorregullatore sjell si pasojë që të vijohet me kuadrin rregullator ekzistues e konkretisht me zbatimin e Ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”. Këto opsione nuk janë opsione të preferuara sepse nuk mund të adresojnë problemin kryesor, përafrimin në mënyrë të plotë të legjislacionit shqiptar me atë të BE në fushën e akreditimit dhe praktikave europiane.

Ndryshimi i ligjit ekzistues është masë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për adresimin e problemit.

Lidhur me analizë e kostove dhe përfitimeve që parashikohet të sjellë ky projektligj, kemi vlerësuar si metodë më të përshtatshme për të analizuar opsionet metodën e analizës me shumë kritere. Kuantifikimi i kostove dhe përfitimeve nga ndryshimet e parashikuara në këtë projektligj në vlerë monetare rezulton i vështirë për t’u bërë.

Opsionet që merren në konsideratë janë:

Opsioni 0 – status quo-ja dhe mos bërja e ndryshimeve ligjore, duke pritur që situata të vetë rregullohet, pa ndërhyrjen e pushtetit legjislativ.

Opsioni 1 – jorregullator

Opsioni 2 (i preferuar)- Kryerja e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin aktual;

Opsioni 3: “Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri”.

Kriteret për vlerësimin e opsioneve dhe pesha e secilit sipas rëndësisë relative janë:

1. Qenia e organizmit akreditues të pavaruar nga organet e vlerësimit të konformitetit, nga presionet tregtare dhe eliminimi i konfliktit të interesave;- 3
2. Aftësia për të adresuar problemet ligjore me synimin për realizimin e objektivës për përafrimin e plotë me Rregulloren e (BE) 765/2008 e datës 9 Korrik 2008 “ Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe shfuqizimi i Rregullores (EEC) Nr. 339/93;- 4
3. Efektiviteti i sistemit të menaxhimit të cilësisë në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17011”2017;- 5
4. Aftësia për të përmbushuar dhe adresuar në mënyrë të plotë dhe efektiv të problematikave me praktikave evropiane në fushën e akreditimit;- 3
5. Aftësia për realizimin e objektivave të politikës në afatin më të shkurtër kohor;- 4
6. Kosto- efektiviteti;- 4

Si rezultat kemi identifikuar 4 kritere me rëndësi për të vlerësuar opsionet të cilat janë të renditura së bashku me peshën respektive në tabelën e mëposhtme:

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Qenia e organizmit akreditues të pavaruar nga organet e vlerësimit të konformitetit, nga presionet tregtare dhe eliminimi i konfliktit të interesave	3	1 (3)	2 (6)	3 (9)	3 (9)
Aftësia për të adresuar problemet ligjore me synimin për realizimin e objektivës për përafrimin e plotë me Rregulloren e (BE) 765/2008 e datës 9 Korrik 2008 “ Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe shfuqizimi i Rregullores (EEC) Nr. 339/93.	4	0 (0)	0 (0)	4 (16)	3 (12)
Efektiviteti i sistemit të menaxhimit të cilësisë në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17011”2017	5	1 (5)	1 (5)	5 (25)	5 (25)
Aftësia për të përmbushuar dhe adresuar në mënyrë të plotë dhe efektiv të problematikave me praktikatat evropiane në fushën e akreditimit	3	1 (3)	1 (3)	3 (9)	3 (9)
Aftësia për realizimin e objektivave të politikës në afatin më të shkurtër kohor	4	0 (0)	0 (0)	4(16)	2(8)
Kosto- efektiviteti	4	1(4)	1(4)	4(16)	2(8)
Pikët		15	18	91	71

Sikurse rezultojn nga analiza opsioni i preferuar rezultojn opsioni 2 i cila ka dhe numrin më të lartë të pikëve me 91 krahasuar me opsionin 0, opsionin 1 dhe opsionin 3.

Çështje të zbatimit

1. *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
2. *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
3. *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Për zbatimin e projektligjit ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e cila ofron shërbimin e akreditimit tek organet e vlerësimit të konformitetit.

Nuk parashikohet të ketë pengesa për zbatimin e kësaj politike. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit i ka parashikaur të marrë të gjitha masat për arritjen e qëllimeve të kësaj nisme ligjore. Drejtoria e Zhvillimit ka hartuar një draft-plan për trajnimin e cdo vlerësuesi . Nga ana tjetër DPA do të përcaktojë, se cilat procedura të sistemit të menaxhimit të DPA do të duhet të ndryshohen me qëllim përfshirjen e vlerësimeve të reja të konformitetit. DPA do të hartojë edhe nje plan për promovimin e akreditimit dhe rolit të tij me qëllim ndërgjegjësimin e OVK në lidhje me kërkesën e legjislacionin për tu akredituar. DPA do të hartojë edhe një plan pune për rritjen e kapaciteteve të saj të brendshme.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi dhe vlerësimi do të kryhet nga ministria përgjegjëse për çështjet e tregtisë, si institucion përgjegjës për mbikqyrjen e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, në bazë të kompetencave të dhëna nga Ligji nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, monitorimi do të kryhet nëpërmjet:

- a. auditimeve vjetore që Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit kryen,
- b. mbledhjeve vjetore të rishikimit të menaxhimit,
- c. planit të monitorimit të performancës së vlerësuesve , për cdo vlerësues me qëllim rritjen e kapaciteteve vlerësuese të trajnuara, të hartuar cdo vit. Nëpërmjet monitorimit realizohet përmirësimi i cilësisë së veprimtarisë së akreditimit.
- d. Rritja e numrit të aplikimeve për akreditim të paraqitura në DPA për fushat e reja të vlerësimit të konformitetit do të tregojë edhe shkallën e plotësimit të legjislacioneve që kërkojnë këto vlerësime.

Tregues i suksesit të projektligjit do të jetë rritja e numrit të organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituara, si dhe zbatimi i standardeve dhe praktikave europiane në fushën e akreditimit.

Treguesit të tjerë për arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre janë:

1. Zero gjetje në raport progresin e BE në për vitin 2023 lidhje me legjislacionin në fushën e akreditimit.
2. Zero moskonformitete në lidhje me kompetencën e audituesve të brendshëm sipas standardit ISO/IEC 17011:2017
3. Rritja e numri i OVK-ve të akredituara nga DPA.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Momentalisht nuk ka impakt buxhetor

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
--	--------	--------	--------	--------	--------	--------	--------	--------	--------	---------

Faktori zbritës													
Kostoja për buxhetin – në													
Kostoja për buxhetin – në													
Kostoja për biznesin – në													
Kostoja për biznesin – në													
Kostoja për grupet e tjera – një herë													
Kostoja për grupet e tjera – në vazhdim													
Kostoja në total													
Kostoja e zbritur në total = Kostoja në total x													
Përfitimi për buxhetin – në													
Përfitimi për biznesin – në													
Përfitimi për biznesin – në													
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë													
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim													
Kostoja për buxhetin – në													
Përfitimi në total													
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës													
Vlera aktuale e kostonë													
Vlera aktuale e përfitimit në total													
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit													

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni (Te plotësohet nëse informacioni është i mjaftueshëm)

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0

MINISTËR

Delina Ibrahimaj